

AKTI I THEMELIMIT

dhe

STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR **Dolcka Building**

Sot me daten 20.11.2024 ne ortaket Vladimir Ibro dhe Enio Ibro madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar bazuar ne Ligjin nr 9901 date 14-04-2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, ne cilesine e ortakeve, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, nepermjet ketij dokumenti themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (shpk) ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise dhe kete akt:

- Vladimir Ibro i biri i Qemal-it, i datelindjes 27/01/1959 banues ne Tirane i identifikuar nga karta e identitetit me nr 033469235 dhe numer personal F90127028A .
- Enio Ibro i biri i Vladimir-it, i datelindjes 21/07/1992 banues ne Tirane i identifikuar nga karta e identitetit me nr 033468154 dhe numer personal J20721063T

NENI 1

EMRI DHE FORMA

Shoqeria quhet : **Dolcka Building** (Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)

NENI 2

SELIA

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Beratit , Lagja Uznove ,rruga Nacionale Berat –Polican , njesi ndertese 1 kateshe , zona kadastrale Nr. 8504 me numer pasurie 214/8-ND.

Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.Kjo shoqeri mund te hap filiale, dege, apo agjensi, apo perfaqesi te saj, si brenda dhe jashte te territorit te Republikes se Shqiperise, konform kerkesave qe parashikon ligji.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekt I veprimtarise se shoqerise : Ndertime industriale, civile, ura germime dheu,me punime eventuate murature e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar,prodhim elemente betoni,beton arme te zakonshem, paparendur, gur dekorativ. Ndertime civile, industriale turistike, bujqesore mbi 5 kate,

rikonstruksione, ndertim banese me skelet mbi 8 kate, ndertim rruge kategoria IV dhe V punime te mirembajtjes dhe sinjalizimeve rrugore, ndertim ura dhe vepra arti deri nr 10 m, estakada-ura metalike te varura. Ndertim ujesjelles kanalizime, kanale impjante vaditese, ndertim diga-damba deri ne 10 m. punime nesiperfaqe te gjelberta parqe-pyll, parqe, pastrim i siperfaqeve urbane kryerje e punimeve ne sherbesat funerale. Mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane, ndriqimi dhe sinjalizimi urban. Punime mbrojtjeje dhe sistemime hidraulike 10/a. Rikonstruksion godina civile e ekonomike, veshje fasadash etj. Ndertim rruge, ura dhe vepra arti. Kerkim dhe shfrytezim miniera.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE VULA

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine tregtare per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Shoqeria ka vulen dhe specimentet e saj.

NENI 5

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortaket e kesaj shoqerie gezojne keto te drejta:

- Marrin pjese ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise, ne perputhje me Aktin e Themelimit (kontrata) dhe Statutin e kesaj shoqerie, vete drejteperdrejte ose me persona te autorizuar sipas ligjit.

-Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise, se shoqerise ne cdo forme dhe sasi ne perputhje me Statutin e saj.

-Te marrin pjese ne organet e shoqerise, jane ose mund te krijohen, vete ose nepermjet perfaqesuesit te secilit, sipas menyres se perfaqesimit te parshikuar ne ligj.

- Te kerkojne ti jepet secilit ortak te gjitha informatat qe bejne me gjendjen tregtare te shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato per shqyrtim perpara organeve te shoqerise.

Te emertojne dhe shkarkojne perfaqesuesit e kesaj shoqerie, punonjesit, ekspertet kontabel dhe financiar, dhe eatoret e shoqerise.

-Te heqin dore (secili) nga shoqeria. Heqja dore nga shoqeria nuk liron asnje ortak nga detyrimet financiare te marra me pare nga shoqeria.

Ortaket e shoqerise kane keto detyra kryesore:

-Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise ndermjet organeve te krijuara prej tyre.

NENI 6

Administratori

Administratoret e shoqerise Dolcka Building jane caktuar Z. Vladimir Ibro i datelindjes 27.01.1959 me karte identiteti nr 003369235 dhe nr personal F90127028A dhe Enio Ibro i datelindjes 21.07.1992 me karte identiteti nr033468154 dhe nr personal J20721063T me vullnetin e lire dhe te plote te tyre dhe te gjithë ortakeve me nje afat 5(pese) vjecar me te drejte rizgjedhje . Administratoret e shoqerise perfaqeson shoqerine me te tretet konform permbajtjes se Kodit Civil dhe Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise-per formen dhe menyren e perfaqesimit ligjor.Administratori e pushon veprimtarine e tij kur:

- Japin doreheqjen
- Perfundon afati
- Asambleja mund te shkarkoje administratoret ne cdo kohe me shumice te zakonshme .Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine ,rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 7

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtaris se shoqerise Dolcka Building eshte pa afat. Kjo periudhe mund te ndryshoje kur kerkohet nga te gjithë ortaket e ke saj shoqerie, parahikohet shprehimisht ne ligj – si dhe kur ortaket e kesaj shoqerie e mbyllin veprimtarine pasi aktiviteti i shoqerise (bilanci ekonomik) rezulton me humbje.

NENI 8

Kapitali

Kapitali themelor shoqerise Dolcka Building eshte 3 000 000 ne 2 pjese , per ortakun Vladimir Ibro pjesa e tij eshte 1 530 000 lek ose 51 % e kapitalit dhe Enio Ibro pjesa e tij eshte 1 470 000 lek ose 49% e kapitalit . Ky kapital do te shlyhet pas regjistrimit te shoqerise ne QKB.Kapitali mund te shtohet apo pakesohet me miratimin e pelqimin e te gjithë ortakeve te kesaj shoqerie duke u shprehur me shkrim per kete qellim dhe te pasqyrohet ne aktet e kesaj shoqerie..

NENI 9

Kompetencat e administratoreve

Administratoret e shoqerise Dolcka Building Z.Vladimir Ibro dhe Z.Enio Ibro se bashku me ortaket e shoqerise kane te drejten e caktimit te Drejtuesit teknik te shoqerise,ne raste se shoqerise do ti duhet nje strukture e tille, duke caktuar nje person qe ploteson kriteret profesionale dhe eshte i pajisur me License nga organi kopotent, qe ti pergjigjet objektit te veprimtaris se kesaj shoqerie. Administratori/et jane pergjegjes] administrimin e Shoqerise dhe perfaqesojne Shoqerine tek palet e treta, ne perputhje me dispozitat e ketij Stauti dhe legjislacionin ne fuqi.

Kompetencat dhe detyrat e administratoreve ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise do te perfshijne, por pa u kufizuar, si vijon:

- (i) zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
- (ii) te sigurojne pajtuesmerine e Shoqerise me ligjet dhe standardet e kontabilitetit;
- (iii) te kryerjete te gjitha veprimet lidhur me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
- (iv) te sigurojne mirembajtjen e rregullt te dokumenteve financiare dhe kontabel te Shoqerise;
- (v) te perfaqesohne Shoqerine tek paleve te treta;
- (vi) te kryerjete te gjitha regjistrimeve dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine siç kerkohet nga legjislacioni ne fuqi;
- (vii) te kryerjete detyrat te tjera te parashikuara nga ligji dhe nga ky dokument.

Administratoret mund te ushtrojne te gjitha kompetencat dhe veprimet, me perjashtim te atyre qe me ligj dhe me kete dokument i jane te rezervuara per Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ose jane te kufizuara nga ky dokument ose ligji ne fuqi.

Administratoret mund te delegojne nje pjese ose te gjitha kompetencat e tyre personave te tjere.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton, me vendim te duhur, kufijte e kompetencave, shtrirjen e kompetences se çdo administratori dhe nese eshte e nevojshme, procedurat per mbledhjen e tyre.

NENI 10

Auditoret

Nese kerkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, kontrolli i pasqyrave financiare dhe te regjistrave kontabel te Shoqerise do t'i besohet nje ose me shume auditoreve ligjore.

NENI 11

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

Viti financiar fillon ne daten 1 Janar dhe perfundon ne daten 31 Dhjetor te çdo viti.

Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon ne daten 31 Dhjetor 2024.

Pasqyrat vjetore financiare, inventari dhe raporti i administratorit/ve dhe auditorit, nese ka, miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne perputhje me Ligjin per Shoqerite e Tregtare.

NENI 12

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Organi me i larte i shoqerise Dolcka Building eshte Asambleja e ortakeve qe perbehet nga te gjithë ortaket e kesaj shoqerise dhe kopetenca ushtrohen prej te gjithë ortakeve. Asambleja e pergjithshme e ortakeve perfaqeson te gjithë ortaket, dhe vendimet e saj te marra ne zbatim te legjislacionit dhe ketij dokumenti, jane te detyrueshme per te gjithë ortaket. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese, nder te tjera, per vendimet ne lidhje me sa vijon:

- i. percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
- ii. ndryshimin e Statutit;
- iii. emerimin dhe shkarkimin e administratoreve, auditoreve dhe likuiduesve si dhe shperblimin e tyre;
- iv. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret;
- v. zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise,
- vi. transferimin e kuotave;
- vii. shperndarjen e dividendit; riorganizimin dhe/ose shperberjen e Shoqerise;
- viii. dhe çdo çeshtje tjeter te percaktuar nga legjislacionin ne fuqi dhe ky Statut

NENI 13

Shoqeria Dolcka Building mund te lidhe kontrata te ndryshme me te tretet si me persona fizik apo juridike, vendas apo te huaj me netet shtetore dhe private, duke i kryer keto veprime nga pikepamja procedurale nga administratoret e shoqerise duke marre pelqimin e te gjithë ortakeve.

NENI 14

Ne veprimtarine e saj ekonomike shoqeria Dolcka Building perfaqesohet nga te dy administratoret e saj Z Vladimir Ibro dhe Z.Enio Ibro , ose nga persona te tjere te autorizuar prej tij sipas menyres dhe formes qe parashikon ligji, por pasojat qe rrjedhin nga cdo veprimtri e kesaj shoqerise jane ne ngarkim te te gjithë ortakeve te kesaj shoqerise.

NENI 15

Shoqeria Dolcka Building eshte pergjegjese per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se saj, per sigurimet shoqerore e shendetesore per ortaket e shoqerise, edhe per ata qe do te punesohen prane kesaj shoqerise dhe qe ne kontraten e pare do te meret ne ngarkim nje kontribut I tille. Shoqeria ka te drejte te cele llogari likuiduese prane cdo banke shtetore apo private, vendase apo e huaj dhe te kryej veprimtari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 16

Per sigurimet e veprimtarise e konomike shoqeria Dolcka Building ka te drejte te vetefinancohet ne leke shqiptare apo valute te huaj, duke kryer dhe shkembimin e monedhes shqiptare (lek) ne valute te huaj (euro, dollare, apo cdolloj valute qe eshte e vlefshme per konvertim) duke e bere kete konvertim sipas kursit zyrtare te bankes se Shqiperise, apo edhe me kursin e tregut te lire, mjafton qe ky veprim te kete miratimin e te dy ortakeve te shoqerise.

NENI 17

Per pasqyrimin e aktivitetit ekonomik te shoqerise administrator i saj mund te caktoj specialist nepermjet punesimit ne rruge ligjore- te cilet pasi te kryejne veprimin e duhur duhet ta pasqyrojne ate ne akte e regjistra te miratuar edhe nga organet tatimore fiskale te shtetit, dhe tja paraqesin dhe ortakeve te kesaj shoqerie per tu vene ne dijeni.

NENI 18

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbyllet ne fund te muajit dhjetor te cdo viti kalendarik. Kete veprimtari dokumentohet nga eksperti kontabel I njohur nga ligji dhe i autorizuar nga administrator i shoqerise nese kjo gje eshte e nevojshme ,I cili pasqyron bilancin vjetore te shoqerise, si dhe deklarimin e te ardhurave, dhe te legalizojte dhe depozitoj kete bilanc dhe ne organin tatimor e financiar, ne juridiksion te ciles eshte dhe veprimtaria e kesaj shoqerie.Pasi paguhen detyrimet si taksa tatime , shpnezime te tjera te domosdoshme , pagat e punonjesve te shoqerise , mbetet fitimi neto i cili ndahet ne favor te ortakut te vetem i cili eshte dhe pronar perfitues i vetem.

Ortaket mbartin mbi vete rrezikun e falimentimit deri ne masen 100% te kapitalit themeltar dhe atij rezerve

NENI 19

Ortaket e kesaj shoqerie ne mbledhjen e ortakeve vendosin per shtimin apo pakesimin e numrit te ortakeve si dhe per pranimin ne mardhenie pune prane kesaj shoqerie te personave te trete(fizike apo juridike, shqiptar apo te huaj) duke percaktuar edhe kriteret teknike e ligjore per punesimin e tyre, si dhe llojin e punes, masen dhe menyren e shperblimit, dhe detyrimet e tjera qe burojne dhe parashikohen ne Legjislacionin e punes, si dhe ne Kodin e Punes, dhe aktet e tjera qe kane dale ne baze e per zbatim te tij.

NENI 20

Pjesemarrja ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, thirrja, kuorumi dhe vendimet

- Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe te votoje ne perpjesetim me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise.
- Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga çdo person tjetër ne baze te nje prokure me shkrim i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht ortak. Ne çdo rast, prokura mund te jepet vetem per nje

mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e vlefshme per mbledhjen e pare dhe te dyte me te njejtin rend dite.

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga perfundimi i vitit financiar, per miratimin e pasqyrave financiare te Shoqerise, dhe sa here qe Administratori e gjykon te nevojshme, ose kur kerkohet me shkrim nga nje ose me shume ortak qe zoterojne te pakten 5% (pese per qind) te kapitalit te kuotave te Shoqerise.
- Ortaket do te njoftohen per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve me nje leter rekomande (poste te regjistruar) me vertetim marrje ose email ne adresat e njoftuara. Njoftimi duhet te tregojte rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe do t'i dergohet çdo ortaku jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te perfshije edhe menyren e pjesemarrjes ne Asamblese e Pergjithshme te Ortakeve dhe/ose menyren e vendimmarrjes. Njoftimi i mbledhjes mund te parashikojte edhe nje date te dyte per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve nese mbledhja e pare nuk zhvillohet sipas njoftimit, ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti. Nese njoftimi i mbledhjes dergohet me e-mail, njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne daten dhe orarin e treguar ne mesazhin e pranimit/dorezimit te njoftimit me email.
- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te mbahet ne seline e regjistruar ose ne çdo vend tjetër brenda Republikes se Shqiperise ose jashte saj.
- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te mbahet ne formatin audio ose videokonference, me kusht qe te gjithe pjesemarrësit te identifikohen nga kryetari dhe t'u jepet mundësia te ndjekin diskutimin dhe te marrin pjese aktive ne te. Pas verifikimit te ketyre kerkesave qe duhet te paraqiten ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbajtur ne vendin ku jane te pranishem kryetari dhe sekretari i mbledhjes.
- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te konsiderohet e thirrur dhe e mbajtur siç duhet edhe nese nuk jane respektuar te gjitha formalitetet qe rregullojne thirrjen, me kusht qe te jete i pranishem i gjithe kapitali i kuotave dhe te gjithe ortaket e pranishem ne mbledhje bien dakord per te vazhduar me mbledhjen pavaresisht nga parregullsia e thirrjes.
- Ne çdo rast, ne mungese te kuorumit, asnje veprim nuk do te behet ne mbledhjen e tille dhe Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te mblidhet jo me vone se 30 (tridhjetë) dite ne te njejtin vend dhe ne te njejten menyre si ishte planifikuar Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e pare.
- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve kryesohet nga kryetari i caktuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Ne procesverbal, kryesuesi i mbledhjes cakton nje sekretar per mbajtjen e procesverbalit.
- Vendimet dhe procesverbalet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve duhet te jene me shkrim dhe te nenshkruhen nga kryetari dhe sekretari. Vendimi duhet te perfshije, me kerkese te ortakeve, deklaratat si dhe qendrimit e tyre.
- Ne rast se ortaket ftohen te vendosin permes vendimit me shkrim, kuorumi do te konsiderohet i arritur ne baze te numrit te ortakeve qe dergojne votat dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose çdo ortak qe ka kerkuar vendimmarrjen duhet t'i dergoje çdo ortaku njoftimin ne lidhje me vendimin me shkrim, i cili do te permbaje te gjitha informacionin qe permban njoftimi/thirrja siç parashikohet ne kete Statut. Procedura e vendimmarrjes me shkrim do te jete ne perputhje me paragrafet e ketij neni, kurdohere qe eshte e nevojshme. Çdo ortak duhet te shprehe me shkrim mendimin e tij ne lidhje me projekt-vendimin dhe te votoje projektvendimin ne formen e dhene nga Administratori, duke shkruar "pro" ose "kunder" ose duke shprehur komentet e tij ne nje dokument tjetër. Nese ortaket kane komente, ata duhet t'i referohen qarte projekt-vendimit. Çdo

ortak duhet t'i dergoje administratorit ose ortakut qe kerkon miratimin e vendimeve me shkrim, voten/vendimin e tij me shkrim brenda dates se percaktuar ne njoftimin e derguar per vendimin me shkrim.

- Pervec rasteve kur parashikohet ndryshe nga kete Statut ne rast te vendimmarrjes qe kerkon nje kuorum te zakonshem, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese anetare qe zoterojne me shume se 30% te kuotave me te drejte vote. Vendimet do te miratohen me shumicen e votave e te pakten 50% te ortakeve qe marrin pjese ne mbledhje.
- Per ceshtje qe kerkojne kuorum te kualifikuar si p.sh:
- ndryshimi i Statutit; zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit aksionar te regjistruar;
- shperndarja ekuotave; riorganizimi dhe shperberja e shoqerise;
- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ne votim marrin pjese anetare qe kane me shume se gjysmen (50%) te numrit te pergjithshem te votave. Ne kete rast, vendimet do te miratohen me shumice votash prej te pakten 75% te ortakeve qe marrin pjese ne mbledhje.

NENI 21

Dokumentimi

Dokumentimi i marrdhenieve te punes ndermjet shoqerise Dolcka Building si pale punedhenese dhe cdo te treti si pale punemarrese do te rregullohen ne baze te neneve qe parashikohen te kodi i punes dhe aktet e tjera neneligjore, duke perpiluar kontrata pune individuale apo kolektive sipas rastit dhe natyres qe kerkon ligji duke neneshkruar per shoqerine nga administratori i saj ose nga cdo person i autorizuar prej tij. Shoqeria eshte e detyruar qe pervec dokumentacionit kontabel dhe librave te tjere dhe :

- Librin e ortakeve ne te cilen shenohet emri i plote dhe kuota e kapitalit te ortakeve.
- Libri i mbledhjeve dhe i veprimeve te organit vendimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i veprimeve te organit administrativ.

NENI 22

Shperberja dhe Likuidimi i Shoqerise

Shoqeria mund te priset me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te marre ne baze te kuorumit te vlefshem te percaktuar ne kete Statut. Procedura e likuidimit behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve cakton nje ose me shume likuidues, duke percaktuar kompetencat e tyre ne perputhje me ligjet ne fuqi.

Shoqeria do te vazhdoje te ekzistojte si person juridik per qellime te likuidimit deri ne perfundimin e procedures. Gjate procedures ne fjale, emertimi i Shoqerise do te shoqerohet nga fjalet "ne likuidim".

NENI 23

Legjislacioni ne Fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarveshjeve

Ky dokument bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimivlefshmeria dhe zbatimi i tij do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Per çeshtjet qe nuk rregullohen me kete dokument do te zbatohen dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

Ne rast mosmarveshjesh qe lindin ose kane te bejne me interpretimin ose zbatimin e ketij dokumenti, Gjykata e Rrethit Berat eshte kompetente per te zgjidhur çdo pretendim ose mosmarveshje.

NENI 24

Shoqeria merr personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane QKB

Ky Statut i shoqerise Dolcka Building u perpilua me vullnet te lire te gjithe ortakeve te kesaj shoqerie sot ne daten 20.11.2024 kopje te barasvlefshme me njera tjetren dhe neneshkruhet nga te gjithe ortaket e shoqerise dhe nje kopje e ketij statuti depozitohen ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 25

Per gjithcka qe nuk eshte shprehur ne statutin e kesaj shoqerie do ti referohet ligjit nr 9901 date 14.04.2008 ” Per tregetaret dhe Shoqerite tregtare ” i ndryshuar dhe dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

“ ORTAKET E SHOQERISE Dolcka Building ” SH.P.K

Vladimir Ibro



Enio Ibro

